

MANUAL MBI RITJEN E PULAVE

Ky manual praktik ka për qëllim të asistojë organizatat tona partnere për mbajtjen e koteceve me pula të shëndetshme në qendrat e tyre sociale ku ato kujdesen për njerëzit në nevojë. Ne shpresojmë që ju do të argëtoheni me pulat dhe do të keni një burim cilësor e të vazhdueshëm të vezëve.

Lumturia dhe shëndeti i pulave kanë rëndësi në mënyrë që pula të sigurojë cilësi të mirë veze. Fatmirësisht, pulat janë qenie të thjeshta për t'u kujdesur. Ato kanë nevojë për rutinë të përditshme, ushqim, ujë dhe qetësi. Me anë të eliminimit të stresit, ato do të bëjnë atë që dinë të bëjnë më mirë; vezën cilësore. Mbani mend se pulat kërkojnë punë të përditshme dhe se do ju duhet t'u shërbeni atyre çdo ditë.

Pse vezë dhe pula? Sepse...

- Pulat tuaja do ju japin vezë vetëm pak ditë pasi t'i merrni
- Vezët janë nga ushqimet më të mira në botë
- Ju jep mundësinë për të siguruar një pjesë të ushqimit tuaj
- Ju jep mundësinë të bëni diçka aktive dhe që nuk e humbet kurrë vlerën
- Puna rrit dinjitetin dhe vetëvlerësimin e personave përfitues
- Ju mund të shtoni tufën dhe të shisni vezët për fitim

Gjërat kryesore që pulat kanë nevojë

- Ushqim dhe ujë
- Ngrohje të mjaftueshme
- Kotec te pastër e të thatë si dhe një vend ku të hanë dhe luajnë
- Një vend me rërë për t'u shkundur

Vezët

Pulat fillojnë të bëjnë vezë kur bëhen rreth 7 muajshe. Ato prodhojnë për disa vite rresht. Për të ndihmuar ato të bëjnë vezë pa stres, krijoni një zonë të veçantë për koshin ku pulat ulen për të bërë vezët dhe mbajeni të errët për të ulur stresin. Pulat lëshojnë vezë nga ora 10:00 deri në orën 14:00.

Ushqimi

Për zogjtë e vegjël, siguroni ushqim në çdo kohë. Kurse për pulat, 2-3 herë në ditë është mjaftueshëm. Për zogjtë e vegjël, siguroni ushqim me proteinë të shtuar, rreth 18-21%. Pasi ato bëhen 3 javëshe, u jepet ushqim me 15% proteinë.

Ushqimi jepet herët në mëngjes dhe pastaj gjatë pasdites (rreth orës 08:00 dhe 15:00).

Ushqimi lihet jashtë vendit ku flejnë.

Nëse pulat jetojnë jashtë dhe kanë më shumë hapësirë, ato mund të konsumojnë deri 25% të ushqimit të tyre nga hapësira ku jetojnë.

Pulat hanë pothuajse çdo mbeturinë nga ne. Kujdes: mos u jepni pulave ushqim me myk apo të prishur.

Në muajt e ftohtë, pulat kanë nevojë për më shumë energji dhe hanë më shumë.

Në darkë, sidomos në ditët e ftohta, është mirë të hanë diçka proteinike që do i mbajë gjatë natës. Psh, misër.

Kalciumi shtesë

Kur zogjtë bëhen 18 javësh, fillohet edhe me shtimin e kalciumit sepse ato po përgatiten për të bërë vezë. Kalciumi u duhet pulave që bëjnë vezë, jo pulave që rriten për mish. Çdo vezë ka rreth 4 gr. kalcium në lëvozhgë dhe pula do e sigurojë nga diku këtë kalcium. Nëse jo nga ushqimi, ajo do e marrë nga kockat e saj.

Përzieni rreth 5% pluhur gëlqereje në ushqim (ndihmon në formimin e vezëve).

Lëvozhgat e vezëve mund të piqen për 10 minuta në furrë e më pas të thërrmohen.

Lëreni masën me kalçium (lëvozhga vezësh të thërrmuara, guaska të thërrmuara ose gëlqere) afër ushqimit por në një enë më vete. Vetëm pulat që prodhojnë vezë do e konsumojnë kalciumin, kurse gjelat apo zogat jo.

Uji

Uji është i rëndësishëm për pulat. Siguroni ujë të pastër dhe të rrjedhshëm për to.

Uji duhet të ndërrohet çdo ditë dhe mundësisht, ena e ujit duhet të lahet çdo ditë. Sidomos, zogjtë pinë shumë ujë dhe duhet të kihet vëmendje që nuk u mungon.

Temperatura

Pulat nuk kanë nevojë për ngrohje edhe kur temperatura është minus pasi ato e kanë temperaturën e trupit, rreth 40-41° dhe kanë pupla. Kurse zogjtë e vegjël kanë nevojë për ngrohje për rreth 4-5 javët e para të jetës.

Drita

Pulat bëjnë më shumë vezë në muajt e ngrohtë dhe më pak në dimër. Kjo sepse në dimër ka më pak dritë.

Gjithsesi, nuk sugjerohet që të shtohen drita në kotec gjatë dimrit me qëllim që pulat të bëjnë më shumë vezë. Ato kanë nevojë për pushim.

Banjot e pluhurit

Është 'dushi' që bëjnë pulat dhe tepër i nevojshëm për shëndetin e tyre. Banja u heq parazitët dhe morrat që kanë pulat.

Siguroni një hapësirë me rreze rreth 50 centimetra, një vend me dhe, rërë dhe hi.

Gjelat

Gjelat nuk janë të nevojshëm që pula të bëjë vezë. Gjelat janë të nevojshëm nëse duam të kemi vezë të fekunduara për të nxjerrë zogj.

Raporti i gjelave me pulat të jetë rreth 1 gjel me 13-15 pula.

Gjelat i drejtojnë dhe i mbrojnë pulat.

Koteci

Duhet të ketë ajrosje në pjesën e sipërme që të lëvizë ajri dhe të dalë lagështira e tepërt. Mbajeni ambientin e kotecit të ajrosur si dhe këmbët e pulave të thata.

Koteci duhet të mos ketë rryma ajri. Për këtë, mund të shtoni 5-10 cm shtresë rërë ose tallash të trashë.

Të vendosen drurë rreth 3-5 centimetra të gjerë për të fjetur pulat natën (roosting).

Hapësira duhet të jetë 3 pula për çdo m² kurse ambienti i jashtëm të ketë 1 m² për çdo pulë.

Foleja për vezë

Të jetë e qetë, e errët dhe e fshehur, në vend të sipërm brenda kotecit. Ajo duhet të mbahet e pastër gjithmonë dhe vezët të mblidhen çdo ditë. Kujdes: foleja nuk është që pula të flerë por që të bëjë vezën. Zakonisht, duhet 1 fole për 3-5 pula.

Siguria

Gjatë natës sidomos, pulat janë krejtësisht vulnerabël dhe nuk kanë mbrojtje. Prandaj, duhet të eleminohet mundësia e predatorëve, macet, qentë, skifterët, etj. Për këtë, të shikohet mundësia që të vendosen rrjeta të groposura rreth 50 cm thellë.

Kur pulat tremben gjatë natës, ato mund të ndalojnë së prodhuari vezë. Prandaj sugjerohet që koteci të mbulohet gjatë natës.

Të tjera shkurtimisht:

Pulat kanë nevojë për aktivitet fizik si dhe vend me bar.

Rënia e pendëve ndodh zakonisht gjatë vjeshtës. Duhet rreth 2-3 muaj që pula të zëvendësojë pendët e saj.

Gjatë kësaj periudhe, është e rëndësishme t'u sigurohet ushqim pasi është periudhë stresi për to. Rënia e pendëve fillon kur pula është rreth 18 muajshe, në vjeshtë pasi mbyll prodhimin e vezëve. Kjo mund të përsëritet çdo vit.

Një kotec me pula është gjithashtu një mundësi shumë e mirë për të ulur mbetjet tuaja ushqimore.

Për nevoja specifike, lutemi konsultohuni me veterinerin tuaj. Pulat janë qenie të forta dhe mbijetojnë në shumë situata. Por ato janë shpendë tërësisht të varura nga ju, prandaj, bëni kujdes për të plotësuar nevojat e tyre.

Mos harroni se një pulë e lumtur bën vezë të shëndetshme.